



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN
KRYESISHT NGA KQZ PËR PLOTËSIM TË VAKANCËS NË KZAZ**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 09.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 30, neni 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", ndryshuar, ka publikuar në faqen zyrtare të institucionit, dhe përgjatë tre ditëve në gazetat "Panorama", "Koha Jonë", "Shqiptarja.com", kërkesën për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.



Nr. 140 i Vendimit

Data 09.04.2019 e Vendimit

Ora 11.00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ

Në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, kanë aplikuar duke paraqitur kërkesë shoqëruar me dokumentacion përkatës 324 shtetas.

Pas shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të të dhënave, rezulton se 318 shtetas plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 30, dhe 31, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ, sipas lidhjes Nr.1 bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

